



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura VI**  
Sesioni pranveror

**Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi**

Mbledhja nr. 25  
Prishtinë, më 12.6.2018, në orën 10:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 303

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Ismajl Kurteshi, kryetar, Teuta Haxhiu, Nezir Çoçaj, Adem Mikullovc, Arbërie Nagavci, Valentina Bunjaku – Rexhepi, Abdyl Salihu Mufera Shinik dhe Verica Çeraniq.

**Mungoiuan:** Fidan Rekalju dhe Albulena Balaj – Halimaj.

**Përfaqësues të tjerë:** Shyqiri Bytyqi, ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Mustafa Kadriu, udhëheqës i Divizionit për Vlerësim Standarde dhe Monitorim/MASHT, Murteza Osdautaj, drejtor i Departamentit të Shkencës/MASHT, përfaqësues të KDI dhe mediave.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Shaip Goxhuli dhe Lule Ymeri

Mbledhjen e kryesoi, Ismajl Kurteshi, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky :

**Rend i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 16, 21, 23, 24 dhe 28 Maj 2018;**
- 3. Diskutim lidhur me testin e Maturës Shtetërore;**
- 4. Shqyrtim i Projektligjit nr. 06/L-049 për Inovacion Shkencor dhe Transfer të Dijes dhe Teknologjisë;**
- 5. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

### **2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 16, 21, 23, 24 dhe 28 maj 2018**

Procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 16, 21, 23, 24 dhe 28 maj 2018, u miratuan pa vërejtje.

### **3. Diskutim lidhur me testin e Maturës Shtetërore**

**Ismajl Kurteshi**, në lidhje me mbarëvajtjen e testit të Maturës Shtetërore, tha se MASHT-i ka proklamuar që këtë vit të mos përsëritet kopjimi siç ka ndodhur viteve të kaluara. Mirëpo, dukuri të tilla janë evidentuar qysh në ditën e parë të mbajtjes së testit, ku i njëjti është publikuar në rrjetet sociale, gjë që ka qenë shumë brengosëse dhe shqetësuese dhe kërkoi nga ministri informacione lidhur me masat e ndërmarra ndaj shkelësve të rregullave gjatë procesit të mbajtjes së testit të maturës. Ai, tha se gjatë mbajtjes së testit të maturës ka monitoruar katër shkolla në Prishtinë, me ç'rast nuk është vërejtur ndonjë parregullsi, mirëpo, publikimi i testit në rrjete sociale nuk do të duhej të ndodhte asesi.

**Shyqiri Bytyqi**, tha se MASHT-i ka bërë përpjekje maksimale që ky test të shkojë siç duhet dhe të mos ketë parregullsi. Ai tha se është arritur qëllimi parësor i ndarjes në katër regjione të mbajtjes së testit të maturës, i cili kishte për synim të menaxhohet më mirë dhe dukuritë negative që kanë ndodhur në të kaluarën të mos përsëriten. Më tej tha se, MASHT-i duke filluar nga Divizioni për Standarde dhe Vlerësim, ka bërë përgatitjet e duhura në bashkëpunim edhe me DKA-të dhe kjo ka dhënë rezultat të mirë, ndërsa mbajtja e testit në katër regjione ka bërë që testi sivjet të jetë më mirë se çdoherë tjetër

Sa i përket publikimit të testit, ministri tha që në momentin e identifikimit janë marrë masa të menjëhershme ndaj personave përgjegjës dhe mundësia e shkaktimit të dëmit ka qenë e vogël pasi që është bërë në Komunën e Ferizajt. Në këto katër regjione janë zhvilluar katër teste të ndryshme, andaj edhe nuk ka shkaktuar dëm publikimi i testit sepse nxënësit janë njoftuar përmes një komunikatë për media që testi është ndryshe.

Sipas tij rezultatet e testit të maturës gjatë këtij viti do të paraqesin gjendjen reale. Këtë vit testit iu kanë nënshtruar 27 737 nxënës, ndërsa për shkak të parregullsive janë përjashtuar 56 nxënës dhe 8 administratorë, ndërsa nxënësit e përjashtuar do të kenë të drejtë testimi në afatin e dytë kurse administratorët janë eliminuar dhe nuk do ta kenë më mundësinë ushtrimin e kësaj detyre.

**Ismajl Kurteshi**, ngriti edhe çështjen e përmbajtjes së testit në shkollat profesionale, pasi që ka pas raste kur nxënësit janë ankuar se pyetjet në test nuk janë përputhur me plan programin që ata kanë ndjekur gjatë viteve të tyre të shkollimit.

**Shyqiri Bytyqi**, u përgjigj që pyetjet kanë pasur për qëllim përgatitjen e nxënësve për provimin pranues në fakultet. Ai tha se testi ka qenë i ndarë në dy pjesë, ku pjesa e parë synon të testojë njohuritë e përgjithshme të nxënësve ndërsa pjesa e dytë ishte e fokusuar më shumë tek plan-programi.

**Teuta Haxhiu**, tha se brenga e saj qëndron tek organizimi i qendrave në të cilat zhvillohet testi i maturës e që për pasojë i bart edhe këto që kanë ndodh. Më tej tha që ekziston mundësia që testi të ketë dalë nga Ministria dhe se problemi qëndron në mekanizmat e saj. Ajo tha se sipas njohurive që ka testet kanë qenë të njëjta në këto katër qendra, në të cilat është mbajtur testi i maturës. Gjithashtu ajo shtoi që shkollat profesionale nuk po e kanë provimin të bazuar në njohuritë që i marrin gjatë shkollimit.

Sa i përket publikimit të tetë emrave të administratorëve që kanë bërë shkelje, kjo le të shërbejë si mësim për administratorët tjerë që mund të sanksionohen për shkeljet që bëjnë. Ajo kërkoi sqarim nga ministri mbi vendimet që i marrin administratorët gjatë procesit të vëzhgimit.

**Nezir Çoçaj**, tha se për të shmang çdo parregullsi dhe kopjim, duhet të kalohet në maturë digjitale. Sipas tij, kjo është e vetmja mënyrë që të kemi një pasqyrë reale të rezultateve.

**Shyqiri Bytyqi**, tha që testet nuk kanë qenë të njëjta në katër regjionet, por të ndryshme dhe që kjo gjë mund të verifikohet në çdo kohë. Ai gjithashtu tha që testi është publikuar nga nxënësit dhe jo nga MASHT-i dhe në momentin që kallxo.com ka njoftuar Ministrinë mbi këtë ndodhi, Ministria ka bërë gati testin me pyetje të reja për ditën e nesërme. Në anën tjetër, ai tha që të gjithë administratorët kanë qenë të pajisur me njohuri të mjaftueshme për vendimin e pezullimit ose largimit të ndonjë nxënësi nga salla.

Sa i përket testimit digjital, ministri tha që është në planet afatshkurta, mirëpo, që kjo punë kërkon mund dhe buxhet pasi që për realizimin e këtij testi nevojiten diku rreth 30.000 kompjuterë.

Komisioni pas diskutimeve lidhur me procesin e testit të maturës ngriti edhe dy çështje që kanë të bëjnë me arsimin.

**Ismajl Kurteshi**, foli për organizimin e tryezës në bashkëpunim me GIZ-in, lidhur me prioritetet në fushën e arsimit parauniversitar, e cila planifikohet të mbahet më 19 qershor për të përcaktuar prioritetet në fushën e arsimit.

**Shyqiri Bytyqi**, tha që në bashkëpunim me GIZ-in kanë realizuar fushat fushatën “Arsimi në dorën tënde”, ku synojmë grumbullimin e 50.000 nënshkrimeve që arsimit të kalojë në prioritet

buxhetor. Ai tha se në këtë tryezë MASHT-i do të diskutojë mbi pesë prioritete të ndryshme të arsimit që priten të kenë implikime buxhetore.

**Nezir Çoçaj**, kërkoi sqarim nga ministri mbi procesin e zgjedhjes së Rektorit të Universitetit të Prizrenit pasi që në këtë proces ka pasur shkelje të Statutit dhe Ligjit sepse nga 7 vota, 5 duhen për t'u zgjedhur e jo 3 nga sa ka marrë rektori i zgjedhur. Ai gjithashtu tha që qytetarët e Prizrenit po shqetësohen nëse Universiteti i tyre do të mbyllet. Ai tha se njëri nga anëtarët e Këshillit Drejtues ka bartur me vete vulën dhe dokumente të ndjeshme zgjedhor jashtë zyrës dhe që kjo paraqet shkelje dhe mund të dënohet deri me 5 vjet burgim.

**Shyqiri Bytyqi**, tha që MASHT-i nuk ka deklaruar asnjëherë për mbylljen e asnjë Universiteti, mirëpo, është duke u rishikuar vetëm puna dhe aktiviteti i tyre në mënyrë që të përmirësohet gjendja aktuale e cilësisë së arsimit në Kosovë. Ministri gjithashtu shtoi që procesi i përzgjedhjes së rektorit ka qenë i vëzhguar edhe nga përfaqësues të MASHT-it dhe që procedura ka shkuar sipas rregullave dhe pas dy votimeve është zgjedhur rektori aktual.

Ai, gjithashtu tha që sipas raportit të përfaqësueses së MASHT –it, anëtarët e Këshillit janë kërcënuar nga disa persona. Mirëpo, duke qenë se MASHT-i nuk është organ i shkallës së dytë në këtë rast, nuk bart obligime ligjore për të reaguar në këtë aspekt.

**Ismajl Kurteshi**, ngriti çështjen e njohjes së diplomave për të diplomuarit para luftës në Universitetin e Mitrovicës.

**Shyqiri Bytyqi**, deklaroi që nuk është bërë asnjë lloj shkelje nga ana e anëtarëve të Këshillit dhe që ata i kanë përmbushur obligimet e tyre si dhe që MASHT-i nuk mund të marrë përsipër obligime të cilat nuk i takojnë me ligj.

**Teuta Haxhiu**, ngriti çështjen e teksteve shkollore për klasën e gjashtë për lëndën e Biologjisë si dhe theksoi çështjen e volumit dhe peshës së teksteve shkollore.

**Shyqiri Bytyqi**, u përgjigj duke thënë se është bërë shpallja e konkursit për tekstet e reja shkollore, mirëpo, që kjo procedurë merr kohë diku rreth 1 vit. Ai tha se të gjitha tekstet do të jenë në përputhje me plan programet dhe kurrikulat e të gjitha shkollave.

#### **4. Shqyrtim i Projektligjit nr. 06/L-049 për Inovacion Shkencor dhe Transfer të Dijes dhe Teknologjisë**

Komisioni shqyrtoi nën për nen Projektligjin nr. 06/L-049 për Inovacion Shkencor dhe Transfer të Dijes dhe Teknologjisë deri në nenin 9. Anëtarët e Komisionit u pajtuan që si grup punues të vazhdojnë me shqyrtimin e projektligjit.

## **5. Të ndryshme.**

Nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

*E përgatiti:*

*Stafi mbështetës i Komisionit.*

Kryetari i Komisionit,  
Ismajl Kurteshi